



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 1443 Prot.

Durrës, më 26 /01.2024

Lënda: Kërkesë për Shpallje Publike

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE ANALIZËS SË TË ARDHURAVE
Sektorit të Monitorimit të Borxhit

DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE


Tiranë

Në vijim të marrjes së masave për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, mbështetur në Ligjin "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 të D.P.D-së "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", Kreu VI "Njoftimi i Vendimit", pika 3, b) "Rastet e mos marrjes së konfirmimit të njoftimit", si dhe në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, Ju drejtohem për të mundësuar njoftimin e subjektit debitor të poshtëshënuar pasi nga ana jonë nuk është mundësuar Njoftimi Vendimit për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor;

| Nr | Vendimi Administrativ | | Vendimi Rikuperim me Forcë | | Subjekti debitor | | Detyrimi | Penalitete | Interesa |
|----|-----------------------|------------|----------------------------|------------|------------------|------------|----------|------------|----------|
| | Nr. | Data | Nr. | Data | Emri | Nipti | | | |
| 1 | 1081 | 10.10.2023 | 315 | 22.12.2023 | MUHAMED HOXHA | G50131046P | 0 | 60,000 | 0 |
| 2 | 1121 | 23.10.2023 | 316 | 22.12.2023 | NIKU OSMENAJ | H61119090P | 29,698 | 0 | 0 |

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETARI
DENIS SHABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr.21019 Prot.

Durrës, më 27.12.2023

VENDIMI Nr.315, datë 22.12.2023

PËR RIKUPERIMIN ME FORCË TË BORXHIT DOGANOR/AKCIZË

Drejtuar: Subjektit/Shtetasit “MUHAMED HOXHA” me NIPT./ID G50131046P
Durrës, Rr. Pavaresia; Nd. -; ; Durrës; Durrës; 2008; Durrë Tirane

Në zbatim të Ligjit nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; VKM Nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”; Ligji nr.61/2012 “Për Akcizen në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Ju njoftojmë se:

Dega e Doganës Durrës me vendimin Nr.1081, datë 10.10.2023 ka vendosur për shoqërinë / shtetasin, “**MUHAMED HOXHA**” me NIPT./ID **G50131046P**, të shpallet debitor për shumën **60,000 lekë** në formë sanksionesh, si dhe kamat vonest deri në ekzekutimin e detyrimeve të papaguara.

Ky vendim Ju është njoftuar përmes shkresës Nr.16678Prot., datë 10.10.2023 me anë të sherbimit postar, Konferma Postare nr. RR526714100AA, kthyer zarfi me shënimin “*i panjohur*”. Në këto kushte DDD, në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, ka bërë shpalljen publike me anë të shkresës Nr.17782prot., datë 30.10.2023, ku është mundësuar shpallja pranë Bashkisë Durrës, në datë 03.11.2023. Me shkresën nr.17782/1prot., date 13.11.2023/2023, Bashkia Durrës, ka konfirmuar shpalljen, ne date 07.11.2023 prane kendin te fishimit.

Në kushtet kur nga ana Juaj nuk është ushtruar ankimim ndaj vendimit administrativ, Dega e Doganës Durrës në zbatim të nenit 280 të Kodit Doganor/ nenit 103 të ligjit 61/2012 “Për Akcizen në Republikën e Shqipërisë” ka nxjerrë Vendimin Nr.315, datë 22.12.2023 “Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/Akcizës”.

Përmes vendimit Nr.315, datë 22.12.2023 “Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/Akcizës”, Dega e Doganës Durrës ka vendosur si me poshtë;

1. Sekuestrimin e vlerave monetare, kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumentave me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në banka, që i përkasin debitorit, “**MUHAMED HOXHA**” me NIPT./ID **G50131046P**, personave të tretë ose garantuesve që kanë detyrime kundrejt debitorit;
2. Sekuestrimin e mallrave, pasurive të tundshme ose të patundshme që i përkasin debitorit “**MUHAMED HOXHA**” me NIPT./ID **G50131046P**, ose një pale të tretë ose garantuesit që ka detyrime kundrejt debitorit.
3. Kryerjen e sekuestrimit të mesipërm deri në masën , që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve për tu paguar nga subjekti “**MUHAMED HOXHA**” me NIPT./ID **G50131046P**, të percaktuar me vendim Nr.1081, datë 10.10.2023 në shumën **60,000 lekë** në formë sanksionesh, si dhe kamatë vonesat e lindura sipas nenit 107 të Kodit Doganor/Ligjit të Akcizës, në përputhje me normat bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë, për cdo ditë vonesë, nga data e njoftimit të debitorit, deri në datën e likuidimit të të gjitha detyrimeve të papaguara.

KRYETARI
DENIS SHABANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr.21020 Prot.

Durrës, më 27.12.2023

VENDIMI Nr.316, datë 22.12.2023

PËR RIKUPERIMIN ME FORCË TË BORXHIT DOGANOR/AKCIZË

Drejtuar: Subjektit/Shtetasit “**NIKU OSMENAJ**” me NIPT./ID **H61119090P**
Tiranë, Idriz Dollaku; Nd. Belhaus; H. 5; Ap. 4/4; Njësia Administrative Nr. 1; Njësia bashkiake nr. 1; 1004; Tiranë, Tirane

Për dijeni: Agjensisë Doganore “ ” me Kod
Rruga Portit, pranë Terminalit, Durrës

Në zbatim të Ligjit nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; VKM Nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”; Ligji nr.61/2012 “Për Akcizen në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Ju njoftojmë se:

Dega e Doganës Durrës me vendimin Nr.1121, datë 23.10.2023 ka vendosur për shoqërinë / shtetasin, “**NIKU OSMENAJ**” me NIPT./ID **H61119090P**, të shpallet debitor për shumën **29,698 lekë** në formë sanksionesh, si dhe kamat vonest deri në ekzekutimin e detyrimeve të papaguara.

Ky vendim Ju është njoftuar përmes shkresës Nr.17424Prot., datë 23.10.2023 me anë të sherbimit postar, Konferma Postare nr. RR522620340AA, kthyer zarfi me shënimin “*Adrese e pasakte*”. Në këto kushte DDD, në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, ka bërë shpalljen publike me anë të shkresës Nr.18472prot., datë 10.11.2023, ku është mundësuar shpallja pranë Njesisë Administrative Nr.1, në datë 17.11.2023. Me shkresën nr.18472/1prot., date 21.11.2023, Njësia Administrative nr,1, ka konfirmuar shpalljen, në datë 17.11.2023 pranë kendin të fishimit.

Në kushtet kur nga ana Juaj nuk është ushtruar ankimim ndaj vendimit administrativ, Dega e Doganës Durrës në zbatim të nenit 280 të Kodit Doganor/ nenit 103 të ligjit 61/2012 “Për Akcizen në Republikën e Shqipërisë” ka nxjerrë Vendimin Nr.316, datë 22.12.2023 “Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/Akcizës”.

Përmes vendimit Nr.316, datë 22.12.2023 “Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor/Akcizës”, Dega e Doganës Durrës ka vendosur si me poshtë;

1. Sekuestrimin e vlerave monetare, kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumentave me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në banka, që i përkasin debitorit, “**NIKU OSMENAJ**” me NIPT./ID **H61119090P**, personave të tretë ose garantuesve që kanë detyrime kundrejt debitorit;
2. Sekuestrimin e mallrave, pasurive të tundshme ose të patundshme që i përkasin debitorit “**NIKU OSMENAJ**” me NIPT./ID **H61119090P**, ose një pale të tretë ose garantuesit që ka detyrime kundrejt debitorit.
3. Kryerjen e sekuestrimit të mesipërm deri në masën , që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve për tu paguar nga subjekti “**NIKU OSMENAJ**” me NIPT./ID **H61119090P**, të percaktuar me vendim Nr.1121, datë 23.10.2023 në shumën **29,698 lekë** në formë sanksionesh, si dhe kamatë vonesat e lindura sipas nenit 107 të Kodit Doganor/Ligjit të Akcizës, në përputhje me normat bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë, për cdo ditë vonesë, nga data e njoftimit të debitorit, deri në datën e likuidimit të të gjitha detyrimeve të papaguara.

KRYETARI
DENIS SHABANI